



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**V E N D I M**

**Nr. 3 datë 07/ 05/ 2024**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 10/8 DATË 01.08.2023, TË KOMITETIT TË  
INVESTIMEVE STRATEGJIKE, “PËR MIRATIMIN E STATUSIT  
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR  
PROJEKTIN E INVESTIMIT “THE CLIFFS”, PROPOZUAR NGA SUBJEKTI  
ADRIATIC RESORTS SHA NUIS M22221001A DHE ADRIATIC RESORT HOLDING  
UK LIMITED”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 18, të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), vlerësoi se :

- Projekti i investimit strategjik “The Cliffs”, ka përfituar statusin “investim/investitor strategjik” me vendim nr.10/8 datë 01.08.2023, të KIS. Projekti përfshinte një sipërfaqe totale prej 19 000 m<sup>2</sup>, pronë “shtet”. Në përfundim të realizimit të ndërtesës tregtare, subjekti propozon t’i kalojnë Qeverisë Shqiptare në pronësi 12 500 m<sup>2</sup> ndërtim me qëllim përdorimi zyra për institucionet shtetërore apo sipas nevojave të tyre.
- Masa mbështetëse që iu miratua në parim subjektit me vendim të KIS ishte vënia në dispozicion e pasurisë së paluajtshme në pronësi “shtet”, e llojit “truall”, në ZK 8340 me numër pasurie 8/76, në Tiranë. Miratimi përfundimtar i kësaj mase dhe marrëveshja e zhvillimit që do të negociohet ndërmjet subjektit propozues dhe grupit negociues do të

miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe më pas do të propozohen për miratim me ligj të posaçëm në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me nenin 35, të ligjit nr. 93/2015, “Për Turizmin”, të ndryshuar.

- Me vendim nr.4, datë 14.10.2020, të KKT-së, zona te Bulevardi i Ri të Tiranës, me sipërfaqe prej 21 953.42 m<sup>2</sup>, në ZK. nr. 8340, Tiranë është shpallur “Zonë me Prioritet Zhvillimin e Turizmit”, në bazë dhe zbatim të dispozitave të legjislacionit të turizmit.
- Pasuria e paluajtshme me sipërfaqe prej 19 000 m<sup>2</sup>, e llojit “truall” ka kaluar në administrim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me vendimin nr. 47, datë 27.01.2021, të Këshillit të Ministrave, *“Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të një pjese të pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej 19 000 m<sup>2</sup>, nga trualli funksional i pronës ndodhur në Zonën Kadastrale 8340, me numër pasurie 8/76, me sipërfaqe prej 46 266 m<sup>2</sup>, me emërtimin “Stacion Hekurudhor”, Tiranë”.*
- Vlera e investimit parashikohet të jetë 196 700 000 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind mijë) Dollarë dhe të krijohen 1000 (njëmijë) vende pune.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr. 10/8 datë 01.08.2023, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të bëhen këto ndryshime:
  - a) Kudo në vendim emërtesa “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Invacionit”.
  - b) Në pikën 10, fjala “...6 (gjashtë)” muajve...” zëvendësohet me “...8 (tetë)” muajve...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT**

**BLENDI GONXHJA**

**MINISTËR I FINANCAVE**

**ERVIN METE**

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

**MIRELA KUMBARO**

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

**ANILA DENAJ**

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**  
**ODISE MOÇKA**

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**  
**LAURA PLAKU (SARO)**